



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së pestë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 31.05.2018,
e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Visare Gashi (PSD), Nol Nushi (PSD), Drilon Pireva (PSD), Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Adrian Berisha (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Egzon Azemi (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Valbona Petrovci, e pavarur, Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Sami Salihu (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Milazim Vitija (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Naime Osmani (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Migjen Shala (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Florida Canolli (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Yll Bogaj (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Suzan Kika (AAK), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR-AA), Sami Boroci, (AKR-AA), Arbenita Murseli (AKR-AA), Adelina Fazliji (AKR-AA), Rifat Deri (AKR-AA), Bukurie Canolli (LB) dhe Baton Dushi (Nisma).

Munguan: Uran Ismaili (PDK) dhe Sokol Berisha (AAK).

Të pranishëm ishin edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të medieve të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të OSBE-së dhe të KFOR-it.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesuesi i Kuvendit.

Para se të fillonin me diskutim për rendin e ditës, **kryesuesi** i njoftoi të pranishmit për pjesëmarrjen në këtë mbledhje të përfaqësuesve të shoqatave humanitare të koalicionit K-10, për shëndet dhe të drejtat riprodhuese në Kosovë, të cilët do ta bëjnë prezantimin e punës së projektit të tyre.

Elvana Gojani, Visare Mujku - Nimani dhe Dafina Krasniqi, përfaqësuese të Koalicionit K-10, i njoftuan të pranishmit, duke shpalosur planet rreth punës së projektit të këtij koalicioni. Lidhur me Planin diskutuan: Leonora Shabani-Bajraktari, Agim Gashi, Adrian Berisha, Visare Gashi, Blerand Stavileci, Vlora Dumoshi, Leutrim Retkoceri dhe Arben Vitia, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Prezantimi i planit të punës së këtij koalicioni u përkrah nga të gjithë anëtarët e Kuvendit.

Kryesuesi, hapi diskutimin rreth pikave të rendit të ditës.

Egzon Azemi propozoi që në rend dite të futet pika "Diskutim për ndërmarrjet publike komunale".

Eman Rrahmani propozoi që pika "Pyetje dhe përgjigje", të jetë pikë e dytë e rendit të ditës. **Dren Kukaj** bëri të ditur se për shkak të disa problemeve që janë paraqitur në bazë të rekomandimeve të Zyrës ligjore, propozon që pika e shtatë e rendit të ditës "Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizikë", të hiqet nga rendi i ditës.

Blerand Stavileci tha se pikën e shtatë të rendit të ditës ne veç e diskutuam në Komitetin për Politikë dhe Financa, dhe atë ditë kemi kaluar diçka që sot po del që duhet me e tërhequr, andaj duhet ta kemi një sistem se si t'i procedojmë këto lëndë që lidhen me pronën.

Egzon Azemi tha se edhe ne e mbështesim që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës.

Vala Peshku propozoi që nga mbledhja e radhës për secilin takim për mbledhjet e ardhshme, ta fusim si pikë për diskutim nga një ndërmarrje publike komunale.

Fadil Gashi tha se, përderisa ende nuk janë zgjedhur bordet në ndërmarrjet publike, ne si grup parlamentar mendojmë se nuk ka nevojë që kjo pikë të futet në rend dite për diskutim.

Halim Halimi shprehu mendimin se do të ishte shumë me rëndësi që kjo pikë të futet në rend dite për diskutim. Kuvendi është legjitim për shqyrtimin e këtyre çështjeve.

Leutrim Rretkoceri, në emër të grupit, u shpreh në përkrahje të propozimit që kjo pikë të futet në rend dite për diskutim.

Nol Nushi theksoi se kjo pikë që po propozohet për t'u futur në rend dite, paraprakisht është dashur që të propozohet edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, andaj kjo tregon që kërkesat janë tendencioze dhe nuk janë për zgjidhjen e problemit.

Kryesuesi kërkoi që ky propozim të qitet në votim.

Kryesuesi konstatoi se më 24 vota për, 17 kundër, futet në rend të ditës pika "Diskutim për gjendjen në ndërmarrjet publike komunale".

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin që pika "Pyetje dhe përgjigje" të jetë pika e dytë e rendit të ditës.

Kryesuesi konstatoi se më 21 vota për, 19 kundër, pika "Pyetje dhe përgjigje" futet si pikë e dytë e rendit të ditës.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin që nga rendi i ditës të hiqet pika e shtatë "Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizikë".

Kryesuesi konstatoi se me 26 vota për, 12 kundër, hiqet pika e shtatë nga rendi i ditës.

Kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës.

Kryesuesi konstatoi se më 22 vota për, 8 kundër, u miratua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së tretë dhe të katërt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Pyetje dhe përgjigje;
3. Diskutim për gjendjen në ndërmarrjet publike komunale;
4. Propozimrregullorja për të hyrat vetanake të institucioneve kulturore vartëse të Komunës së Prishtinës;
5. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Policisë së Kosovës – Ministria e Punëve të Brendshme;
6. Propozimrregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës;
7. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e lapidarit kushtuar të rënëve francezë të KFOR-it;
8. Propozimvendimi për formimin e Komisionit vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim;
9. Propozimvendimi për themelimin e Komitetit konsultativ;
10. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së tretë dhe të katërt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Egzon Azemi bëri vërejtje në ekstraktet, në pikën "Pyetje dhe përgjigje", duke thënë se në ekstrakt nuk janë përshkruar përgjigjet e drejtorëve. Ai kërkoi që për mbledhjet e radhës, premtimet ose fjalët që japin drejtorët të përshkruhen në ekstrakt.

Më vërejtjen e dhënë, kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratuan ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjes së tretë dhe të katërt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Pika e dytë

Pyetje dhe përgjigje.

Agim Gashi, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale:

- A është në procedurë që të fillojë dezinfektimi dhe deratizimi i hapësirave publike, sidomos në parqet e Prishtinës?
- Kërkoj nga drejtoria përgjegjëse që të jetë në nivel të duhur në mirëmbajtjen e sinjalizimeve vertikale dhe horizontale, ku si p.sh. në kryqëzimin e rrugëve të Xhamia e Llapit, ka 3-4 muaj që është e rrëzuar shenja kryesore orientuese.

Naime Osmani, për Drejtorinë e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimin e Kontratave, Drejtorinë e Urbanizmit, Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm:

- Banorët e lagjes "Kalabria" kërkojnë të dinë se Komuna a ka ndonjë plan për zhbllokimin e kësaj lagjeje, pasi ata e konsiderojnë se janë të izoluar në njëfarë mënyre, sepse për të shkuar në lagjen "Dardania", ata duhet të dalin nga Shkolla Ekonomike ose nga Veterniku.
- Pse nuk po rregullohen rrugët e lagjes "UÇK" në Bardhosh, janë tri rrugë me gjatësi nga 100 - 150 metra?
- Çka do të ndërmerr Komuna për procesin e legalizimit për objektet të cilat janë ndërtuar në periudhën kohore 2000/2004, në themelet e objekteve të mëparshme, dhe ato ende nuk janë të regjistruara dhe nuk paguajnë tatim, ku qytetarët po kanë problem me marrjen e faturës së tatimit për regjistrimin e veturave?
- Banorët e kompleksit "Qafa" pyesin se çka do të bëhet me shkallët që janë në gjendje të mjerueshme, si dhe për mungesën e hapësirës gjelbëruese?
- A janë në plan që të asfaltohen rruga "Naser Krasniqi" dhe disa rrugë të tjera në lagjen "Kodra e Trimave"?
- Banorët afër rrugës "Xhemë Tërnavci", kërkojnë që të bëhet ndriçimi i asaj rruge.
- Të rregullohen semaforët te Xhamia e Llapit nga ndonjë ekspert, pasi që nuk funksionojnë në mënyrë të koordinuar.
- Deri kur do të rregullohen rrugët në përgjithësi të lagjen "Kodra e Trimave" që janë në gjendje të mjerueshme, përkundër taksave që paguhen nga qytetarët?
- A do të ketë ndërtim të banesave kolektive në lagjen "Kodra e Trimave"?
- Pesë familje të fshatit Trudë, pyesin se kur do të asfaltohet dhe ndriçohet rruga e tyre, që është në gjatësi prej 120-130 metra?
- Në fshatin Rimanishtë, a është në plan të rregullohet rruga që qon tek shtëpia e ish-kryetarit të Komunës, Nazmi Mustafa, pasi që aty janë 3-4 pacientë, e sidomos është një paciente e cila hyn në hemodializë dhe vetura e Hemodializës ka probleme me arritur deri te shtëpia?
- Në fshatin Besi, a janë në plan që të shtrohen me kubza rrugët: "Fazli Osmani", "Halit Besia", "Azem Adem Osmani", tek familja e Feim Osmanit rruga e Prebrezëve dhe Mexhuanëve, si dhe një segment i rrugës "15 Marsi" me një gjatësi prej 80 metrave?
- Banorët e lagjeve "Kodra e Trimave" dhe "Kodra e Diellit", kanë kërkuar që të bëhet pastrimi i rrugëve.
- Banorët e fshatrave Rimanishtë dhe Besi, kërkojnë të dinë se a ka Komuna në plan të bëjë sanimin e dëmtimeve në rrugën Besi - Rimanishtë?

Shëfqet Osmani, për Drejtorinë e Shërbimeve Publike:

- A do të bëhet ndonjë zgjidhje për një linjë të transportit publik për tridhjetë fshatra të Gollakut, ku për katër vjet pushtet, dhe tash gjysmë viti pushtet, asnjë linjë e transportit publik nuk ekziston për këto fshatra?

Fiknete Bejta, për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit dhe drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Për vitin akademik 2017/2018, shumë studentë që kanë aplikuar për bursa, kanë vërejtur shumë parregullsi dhe kanë shprehur pakënaqësi. Publikimi me një muaj vonesë i rezultateve që nga shpallja, mungesa e transparencës, mungesa e informacioneve bazë, pikë të grumbulluara, mënyra e vlerësimit të studentëve përfitues, kalkulimi jo i saktë i pikëve etj., kanë ndikuar në shfaqjen e pakënaqësive nga ana e studentëve.
- Banorët e fshatrave të Gollakut kanë një shqetësim rreth taksës së ambientit, ku në ato fshatra nuk ka infrastrukturë bazë për kryerjen e shërbimeve, dhe atëherë si të taksohet një shërbim pa e kryer komuna shërbimin. Propozoj që kjo taksë të rregullohet, nëse nuk arrihet të rregullohet brenda tre muajve, të anulohet dhe të gjendet një zgjidhje tjetër, dhe mundësisht kjo taksë të merret parasysh që në zonën urbane rurale të përgjysmohet.

Jonuz Salihaj, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, tha se sa i përket transparencë së ndarje së bursave, e kam gjetur atë proces në ardhje. Atë çka kam mundur me bërë e kam ndërruar pak strukturën e bursistëve, dhe u kam dhënë përparësi profesioneve që Kosova ka nevojë në tregun e punës, sidomos atyre të agronomisë dhe të përpunimit të ushqimit. E kam rritur për 3-4 bursa më shumë dhe kam e zvogëluar diku në shkencat shoqërore, për të cilat Kosova nuk ka aq nevojë. Ende jemi në proces të ankesave të shqyrtimit, po pranojmë ankesa çdo ditë, nëse kanë bazë poentomi. Normalisht, kriteret janë përcaktuar, është lista e kriterëve dhe nuk kemi devijuar nga kriteret. Kanë përparësi ata që janë jetim, që janë fëmijë të luftëtarëve, veteranëve e kështu me radhë.

Eman Rrahmani, për drejtorin e Drejtorisë së Pronës, drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimin e Kontratave:

- Çka është duke ndodhur me projektin e banesave me kosto të përballueshme, pse nuk është sjellë në Kuvend për t'u votuar, edhe pse ka qenë njëherë në mandatin e kaluar?
- Kur do të fillojë ndërtimi për Tregun e gjelbër afër Komunës, që është premtuar?
- Çka është duke ndodhur me Tregun e automjeteve, i cili është premtuar, në lagjen "Kodrën e Trimave"?
- Çka është duke ndodhur me tregun e shpezëve, e që është premtuar se ai do të zhvendoset nga lagja "Kodra e Trimave"?

- Pse nuk po bëhet pastrimi i rrugëve në Prishtinë?
- Pse nuk kemi kompani që merret me bartjen e makinave, d.m.th. qysh ka qenë "Merimanga"?
- Pse disa lagje të Prishtinës janë pa ujë dhe nuk po ndërmerret asgjë për të, siç është lagjja "Vreshta", sidomos në lagjen "Kodra e Trimave", një pjesë e Bërnices së Epërme dhe një pjesë e Bardhoshit.
- Pse nuk ka filluar ndërtimi i rrugës "Elena Gjika" në lagjen "Kodra e Trimave", e cila është premtuar vitin e kaluar dhe ka dalë në tender.

Halim Halimi, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe për drejtorin e Drejtorisë së Urbanizmit:

- Pse nuk përfundohet rruga Keqekollë – Nishec, rrugë e cila para 7-8 viteve ka filluar të ndërtohet, ku dhe kanë mbetur pa u asfaltuar edhe 2 km, rrugë kjo e cila e lidhë komunën e Prishtinës me komunën e Podujevës?
- Kërkojmë një informatë, apo një raport rreth ndërtimeve pa leje në komunën e Prishtinës.

Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, tha se përgjigjen do ta japim me shkrim, për arsye se qenka një interval kohor para 5-6 viteve, por edhe një gjë tjetër çka mundem ta bëjë unë. Ka qenë një kërkesë e dy asamblastëve të LDK-së, herën e fundit, z. Shefki Gashit dhe Agim Gashit, pas kërkesës së tyre, të nesërmen kemi dal në vend të ngjarjes dhe e kemi vizituar këtë të njëjtën.

Arbenita Murseli, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Kërkoj që të fillohet me projektin për rregullimin e rrugës së degraduar të fshatit Ballaban i Epërm, më konkretisht, për rrugën prej Nishecit deri te shtëpia e Shtabit të UÇK-së.
- Kërkoj që të merren masa për sanimin e rrugës "Sabit Mushica" në lagjen "Sofalia", ku sipas banorëve, kanë shkuar disa punëtorë nga Komuna dhe kanë intervenuar në 2-3 gropa dhe e kanë lënë rrugën në atë gjendje të mjerueshme.
- Banorët e fshatit Tenezhdoll kërkojnë që sa më shpejtë të bëhet ndriçimi i rrugës.

Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, tha se ne jemi që të ju dalim karshi banorëve të qytetit, mirëpo nuk mundemi çdo rrugë që është në vendet jo urbane ta asfaltojmë, sepse momentalisht në Prishtinë kemi shumë hapësirë ku duhet të intervenohet. Sa i përket sanimit të rrugës në lagjen "Sofalia", momentalisht jemi në fazën ku bëhet sanimi i tyre, por ajo rrugë ka nevojë për trajtim komplet, që nënkupton shtrirjen në asfalt, ku prapë kërkohet procedura e tenderimit.

Ismail Kokaj, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, tha se janë të përcaktuara në bazë të buxhetit që e kemi prioritetet. Shpresojmë që gjatë këtij mandati do të mundemi t'i mbërrijë për t'i realizuar edhe kërkesat tjera që kanë të bëjnë me ndriçimin e rrugëve të tjera.

Egzon Azemi, për Shpend Ahmeti, Kryetari i Komunës:

- A mundem që edhe unë ta marrë ndonjë ditë kerrin e Komunës edhe të dalë nëpër qytet dhe t'i kryej ca punë, se po më duhet ashtu si Dardan Sejdiut?!

Milazim Vitia, për drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Fermerët e malësisë së Gollakut, të cilët kanë aplikuar për marrjen e granteve në Ministrinë e Bujqësisë, për një pëlqim urbanistik, shumica prej tyre nuk kanë mundur t'i marrin si pasojë e procedurave burokratike të Komunës së Prishtinës. Kërkoj nga drejtoria përkatëse që t'i zbutë këto kritere dhe fermerët tanë t'i marrin ato pëlqime urbanistike.
- A do të ketë mirëmbajtje verore për mbylljen e gropave në fshatrat e komunës së Prishtinës?

Rifat Deri, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për drejtorin e Drejtorisë së Inspektionit dhe për Kryetarin e Komunës:

- A është ende funksional Komisioni për emërtimin e rrugëve dhe institucioneve, kush janë ata, apo kush kanë qenë anëtarë të atij Komisioni, si është bërë përzgjedhja e tyre, cilat kritere janë paraparë për t'u përzgjedhur si anëtarë i Komisionit për emërtimin e rrugëve dhe institucioneve?
Gjatë takimit me qytetarë, kam marr shumë vërejtje në lidhje me emërtimin e rrugëve. Disa emërtime që po i përmendi, vetëm disa, besoj se të gjithë do të çuditemi se si ka ardhur deri tek ky emërtim, siç janë këto emërtime të rrugëve: "Maja e Dritës", "Ulëza", "Feniksit e Lirisë", "Dritan Hoxha" (ish-drejtor i Top Chanellit), "Uashingtoni", "Qorr Ilazi" etj. Për këtë pyetje besoj se kam me marrë përgjigjen në mbledhjen e ardhshme.
- Kamionët të cilët bartin beton nëpër rrugët e Prishtinës, gjatë bartjes shumica e këtyre derdhin një pjesë të betonit nëpër rrugë, ndërkohë as vozitësit e papërgjegjshëm, as kompanitë që e bëjnë këtë nuk ndëshkohen dhe ky beton i derdhur vetëm se e vështirëson qarkullimin e automjeteve, e ka raste edhe kur dëmtohen ato.
- Kur do të fillojë funksionimi i NPK "Prishtina Parking"?
- A mund ta kemi ndonjë informatë nga drejtoria përkatëse, se çfarë ngjyre është duke u përdorur për shënimin e këtyre korsive dhe vendkalimit të këmbësorëve, se, siç shihet, pas një kohe shumë të shkurtër ato veç po dëmtohen.

Leutrim Retkoceri, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Kur do të përfundojnë punimet në rrugët "Fehmi Agani" dhe "Hajdar Dushi" dhe sa do të vazhdojë ky avaz i premtimit të qytetarëve për afate të shkurtra kohore, e këto punime nuk përfundojnë as me dyfishin e afateve?
- Kur do të fillojnë punët në rregullimin e kolektorit në lagjen "Kalabria"?
- Kur do të përfundojë projekti për rregullimin e shkallëve në lagjen "Arbëria", ku punimet janë duke u neglizhuar dhe banorët e kanë shumë problem me i kaluar ato shkallë?

Kushtrim Sopa, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:

- Kërkoj që mirëmbajtja e varrezave të jetë në nivelin të duhur, pasi që rritja e barit është bërë tej mase, si dhe mbeturinat e shumta të hedhura mbi varreza.
- A është e paraparë që të asfaltohet rruga "Rahman Bahtiri" në lagjen "Kodra e Trimave", që është njëra prej rrugëve të rralla të paasfaltuara në atë pjesë?
- Kërkoj që të bëhet rregullimi i parkut Tauk Bahçe, sidomos pjesa e epërme, e cila është mbuluar me ferra dhe shkurre të ndryshme, që të evitohen rreziqet e ndryshme, me theks të veçantë rreziku nga gjarpërinjtë, të cilët janë shfaqur në masë të konsiderueshme në atë zonë.
- Kërkoj që të bëhet një linjë e transportit publik për bartjen e qytetarëve tek pjesa e Varrezave të Jahudive, që lidhet me Matiqan.
- Kërkoj që volumi i zërit të bashkësive fetare të ngrihet në festa, si për shembull në muajin e Ramazanit, për shkak se në disa zona të qytetit po dëgjohet pak ose fare ezani në kohën e iftarit. Kjo vjen si shkak i vendimit të marrë më herët nga organet kompetente për zvogëlimin e zërit.
- Rruga "Bedri Berisha" në lagjen "Mati 1", është e bllokuar dhe ka vetëm një dalje në rrugën "B", me infrastrukturë tejet të dobët. Komuna kishte premtuar se do ta hapë edhe një udhëkryq që rruga "Bedri Berisha" përmes udhëkryqit në rrugën "Enver Maloku" dhe të dalë në rrugën "B", por deri më sot nuk ka asgjë konkrete. Kërkoj nga drejtoria përkatëse që për ata banorë të bëhet një zgjidhje e mundshme.

Jeta Rafuna - Hasani, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit dhe për drejtorin e Drejtorisë së Kulturës:

- A ka ndonjë plan Drejtoria e Shërbimeve Publike për renovimin, ose mirëmbajtjen e ndërtesave shoqërore, si p.sh. objektet e soliterave, ku pjesët e llamarinave po hiqen nga era dhe po hedhen poshtë, e që po shkaktojnë një rrezik për fëmijët dhe qytetarët në përgjithësi?
- Kur do të përfundojë rregullimi i rrugës "Riqard Hollbruk" në Veternik dhe a do të respektohet afati kohor për përfundimin e këtij projekti?
- Në lagjen "Taslixhe" që 3-4 ditë rresht nuk ka ndriçim publik natën. Ky është një rrezik i madh për qytetarët, duke pasur parasysh se aty ka shumë qen endacakë.

- Pse janë ndërprerë punimet në objektin e ri të shkollës "Don Bosko", kur kemi parasysh që ajo shkollë ka pasur leje ndërtimi?
- Në rrugën prej Fushës së Pajtimit deri tek tuneli, pse asnjëherë nuk është bërë kanalizimi, ku si pasojë ajo rrugë, deri te ish- kazerma, është komplet e shkatërruar?
- A ka ndonjë plan për renovimin dhe restaurimin e "Shtëpisë – shkollë" të Herticëve në lagjen "Kodra e Trimave"?

Yll Rugova, drejtor i Drejtorisë së Kulturës, tha se me pronarin e objektit ku ka qenë shkollë gjatë asaj kohe, jemi në proces që kjo shtëpi të kthehet në Muze të qytetit, që do të na e përkujtonte gjithë atë periudhën e sistemit paralel të arsimit në Kosovë.

Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, tha se sa i përket projektit të rrugës "Riqard Hollbruk", kemi pasur pengesa për realizimin e saj, sepse aty është bërë uzurpimi i pronës publike, ku janë ndërtuar mure. Disa nga ato mure janë larguar me marrëveshje me pronarët dhe disa të tjera i kemi rrënuar në mënyrë të dhunshme.

Po ashtu, jemi në bisedime me Ministrinë e Infrastrukturës, sepse aty parashihet një rreth rrotullim, ne e kemi paraparë rrugën me tri korsi, ndërsa ata e kanë paraparë me dy, kështu që momentalisht jemi duke e reviduar planin.

Sa i përket rrugës prej Fushës së Pajtimit, që i lidh zonat e Gollakut, Grashticë, Mramor etj., shpresoj se në javën e ardhshme do ta kemi një arritje të marrëveshjes, memorandum të bashkëpunimit mes Komunës së Prishtinës dhe Ministrisë së Infrastrukturës, ku ata paraprakisht kanë dhënë pëlqim gojariht se do të na i financojnë gjashtë projekte. Një ndër projektet që do t'i financojë është edhe asfaltimi i tërësishëm dhe kanalizimi i rrugës që fillon nga Fusha e Pajtimit deri në Grashticë.

Po ashtu, ju njoftoj edhe për projekte të tjera që kemi kërkuar nga Ministria e Infrastrukturës që të na ndihmojë, ka të bëjë me planin tonë. Kemi një projekt që e lidhë një rrethrotullim dhe mundësi të qasjes në Dardani, ku aty kemi ngarkesë komunikacioni në lagjen "Dardania", për arsye se e vetmja qasje në rrugën "Bill Clinton" është aty te kryqëzimi i semaforëve.

Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, tha se Plani i mobilitetit vitin e kaluar ka filluar të hartohet nga kompania "M. Mekdolans", si pjesë e kredisë që e kemi pasur me BERZH-in, rreth 51 autobusëve të ri, dhe ky dokument është në përfundim e sipër. Planin e mobilitetit e përcakton lëvizshmërinë e autobusëve, veturave, këmbësorëve dhe biçikletave, është dokument strategjik, i cili pastaj duhet të zbatohet. Sa për informatën tuaj, kemi premtime se diku në fund të qershorit do të përfundojë ky dokument.

Suzan Kika, për drejtorin e Drejtorisë së Urbanizmit, drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit:

- Deri ku do të shtrihet kufiri i fundit në periferi të Prishtinës për ndërtim dhe a po respektohet?
- Trotuaret ende janë të mbingarkuara, me përjashtim të hapësirës së mbrojtur me shtylla, andaj kur dot të ndërmerret diçka në këtë drejtim?
- Si qëndron ruajtja e pyjeve pronë e Komunës dhe sa është përqindja e dëmtimit në raport me periudhat paraprake?

Kumrie Shabani-Ramadani, për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit, drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Në rrugën "Bajram Bahtiri", afër shkollës "Nazim Gafurri", ka shumë shitës të druve, të cilët i parkojnë kamionët e tyre bri rrugës dhe në këtë mënyrë rrezikojnë nxënësit e shkollës dhe gjithë qytetarët që kalojnë atypari.
- Banorët e fshatit Ballaban i Epërm kërkojnë që të bëhet rregullimi i rrugës, pasi që ajo është tërësisht e degraduar.
- Rruga "Muharem Fejza" në disa pjesë nuk ka ndriçim, andaj fëmijët dhe banorët e kësaj pjese janë shumë të shqetësuar, sepse janë të rrezikuar nga qentë endacakë, andaj kërkojnë që të bëhet ndriçimi i rrugës.

Ismail Kokaj, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, tha se jemi duke punuar në tërë qytetin për hapjen e ndriçimit. Në bazë të projekteve që janë paraparë më herët, ato jemi duke i vazhduar. Do të lidhim kontrata të reja dhe ato rrugë do t'i fusim në bazë të prioriteteve dhe kërkesave që janë bërë më herët.

Sa i përket shenjëzimit horizontal dhe vertikal, kemi nënshkruar kontratën, ka diku një muaj e gjysmë, dhe jemi në vazhdimësi të projektit.

Egzon Azemi, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:

- Pse nuk po realizohet projekti për rrethojat e varrezave në Viti të Marecit, edhe pse kushtet janë përmirësuar, sepse arsyeja fillimisht ka qenë kushtet?
- Banorët afër rrugës "Xhemajl Mustafa" në lagjen "Dardania", kundërshtojnë realizimin e projektit, me të cilin fatkeqësisht po tentohet të dëmtohet hapësira gjelbëruese, ku me këtë plan është paraparë të ndërtohen tri vendparkime dhe një rrethrotullim. Konsideroj se këto pak hapësira të gjelbëruara që i kemi në qytet, duhet t'i ruajmë të mos ndërtojmë më tepër beton aty.

Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, theksoi se sa i përket projektit për ndërtimin e rrethojave të varrezave në Viti të Marecit, përgjigjen do t'ua kthejmë me shkrim, ndërsa sa i përket çështjes së Dardanisë dhe rrugës "Xhemajl Mustafa", aty do të ketë më shumë gjelbërim sesa që ka pasur përpara.

Besnik Mujeci, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Pse nuk po shtrohen me asfalt disa rrugë në fshatin Bardhosh?
- Afër shkollës fillore të këtij fshati ka filluar të bëhet një ndotje e madhe nga grumbullimi i mbeturinave. A do të mundet Komuna të intervenojë në pastrimin e këtyre mbeturinave?
- Në rrugën "Delvina", në lagjen "Veterniku", banorët kanë probleme me kanalizimin dhe asfaltimin e asaj rruge, ndërsa në rrugën "Muharem Fejza" vitin e kaluar është shtruar e gjithë rruga, ndërsa sivjet nga ndërtimi i lartë që po bëhet, rruga është dëmtuar skajshmërisht shumë, andaj a do të intervenojë sivjet Komuna në përmirësimin e saj?

Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, tha se mundësia e ndërtimit të rrugëve me kubza është shumë më e lehtë sesa me asfalt. Çdo ndërtim me asfalt kërkon edhe procedurën paraprake të tenderimit. Rruga "Delvina" nuk ka qenë e paraparë për asfaltim në planifikimin që është bërë në vitin e kaluar dhe e vetmja mundësi është se, në rast se kalon buxheti, atëherë kemi mundësi që ta bëjmë këtë.

Valbona Ajeti, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:

- Kur do të fillojnë punimet në Sheshin e Arbrit, rr. "Bajram Bahtiri", më konkretisht te kthesa në anën e majtë?

Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, theksoi se komplet lagjen e Kolovicës e kemi përfshirë në projekt, po ashtu edhe Sheshi i Arbrit është në tenderim e sipër.

Leonora Shabani - Bajraktari, pyetje për kryesuesin dhe për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit:

- Çka është duke u bërë me komitetet, kur do të fillojnë të funksionojnë ato, si p.sh. Komiteti i Arsimit?
- Çerdhet me bazë në komunitet i kanë disa ankesa dhe këto çerdhe orientohen direkt nga kryetari. A ekziston mundësia që këto çerdhet të komunitetit të kalohen në Drejtorinë e Arsimit?

Jonuz Salihaj, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, theksoi se këto çerdhet e komunitetit kanë pak problem me bazën ligjore. Bazohen në një udhëzim administrativ të UNMIK-ut, të vitit 2007, gjegjësisht janë do farë OJQ që e kanë një bord, edhe bordin e kam gjetur që është çift, e bordi çift nuk mund të marrë vendime se mbesin pak në pozicion. Jemi duke u përpjekur, meqenëse është procedurë ndryshimi i Ligjit parashkollor, me e gjetur

një arsyetim me e lidhur me Ligjin për arsimin parashkollor, në mënyrë që baza ligjore të jetë e qartë.

Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, tha se sa i përket projektit të rrugës "Fehmi Agani", sipas planit dinamik, pritet që kjo rrugë të asfaltohet brenda afatit prej 60 ditësh.

Po ashtu rruga "Fehmi Lladrovci" ka qenë e paraparë për 30 ditë, e ka përfunduar për 15 ditë pune. Punimet në Sheshin "Adem Jashari", sipas planit, jemi dy javë ditë para nga afati që është paraparë, që nënkupton se sheshin do ta kemi para afatit kohor.

Po ashtu, sa i përket projektit për shkallët në lagjen "Arbëria", jemi në planin dinamik, që do të thotë do të përfundojmë para afatit të paraparë.

Një rast tjetër e kemi çështjen e rrethrotullimit në lagjen "Lakërishta". Me Doganën e Kosovës jemi pajtuar dhe kemi filluar ta bëjmë daljen, do të thotë urën dalëse në rrethrotullim të Lakërishtës. Jemi ende në bisedime me Hekurudhën, do të thotë me Infrakosin e Kosovës. Në momentin që arrijmë pajtueshmëri, do ta lidhim edhe rrotullimin e Lakërishtës me rrethrotullimin e vogël në lagjen "Arbëria".

Adrian Berisha, për kryesuesin e Kuvendit dhe për drejtorin e Drejtorisë së Kulturës:

- Kur do të bëhet dëgjimi publik i Rregullores për fillimin dhe mbarimin e punës së veprimtarive afariste në territorin e komunë së Prishtinës?
- Pse janë ndarë 1500 euro nga Komisioni, që i ka shpërndarë si subvencione, dhe a ka gjasë me prituri organizatorët e panairit një shumë më të madhe nga Komuna e Prishtinës?

Yll Rugova, drejtor i Drejtorisë së Kulturës, tha se sa i përket çështjes së subvencioneve, sipas Ligjit, pasi të bëhet aplikimi, formohet një këshill vlerësues i pavarur, i përbërë vetëm nga dy anëtarë të Komunës, kurse të tjerët duhet të jenë ose nga Shoqëria Civile ose ekspertë të fushës. Pasi të bëhet vlerësimi i tyre, bëhet një vendim i Komisionit vlerësues, pesë ditë nga shpallja e vendimit mund të bëhen ankesa nga palët, nëse ka pa rregullsi. Ne ende nuk e kemi bërë vendimin final për të bërë ankesë. Në momentin që shpallet vendimi final, atëherë mund të ketë ankesë nga palët.

Eman Rrahmani, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe për drejtorin e Drejtorisë së Pronës:

- Pse nuk ka filluar ndërtimi i rrugës "Elena Gjika", kur është tenderuar vitin e kaluar?
- Çka ka ndodhur me projektin e banesave me kosto të përbalueshme, i cili ka ardhur një herë në Kuvend dhe është kthyer për shkak të mos kalimit të tij?
- Pse nuk është bërë sanimi i rrugës "Ismet Krasniqi", që të kthehet në gjendjen e mëparshme pas dëmtimit nga traktorët e KEDS-it, rrugët të cilat i kanë hapur që nga tetori i vitit të kaluar ende nuk i kanë kthyer në gjendjen e mëparshme?

Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, bëri të ditur se është formuar një komision, i cili me përpikëri do ta bëjë inspektimin e çdo pune të KEDS-it dhe të ndërmarrjeve të tjera. Në një interval kohor shumë të shpejt, unë ndoshta do të bëjë ndërprerjen e bashkëpunimit, që nuk do të ju japim leje këtyre ndërmarrjeve derisa nuk kemi ndonjë marrëveshje me ta, për arsye se nuk jemi të kënaqur me punën që e bëjnë ata.

Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Pronës, tha se sa i përket projektit të banesave me kosto të përballeshme, jemi në përfundim e sipër të këtij projekti. Nuk mund ta them me siguri të plotë se a do të jetë në mbledhjen e ardhshme apo në mbledhjen pas saj.

Vlora Dumoshi, për drejtorin e Drejtorisë së Kulturës dhe për Kryetarin e Komunës:

- A ka Drejtoria ndonjë kalendar të aktiviteteve, a është paraparë ndonjë aktivitet kulturor që qyteti të duket ndryshe, sidomos tash në sezonin e verës, kur dihet se tash mbipopullohet nga ardhjet nga diaspora?
- Te pjesa e subvencioneve, ne e dimë që ka shumë njerëz që konkurrojnë, por në komisionet të cilat janë formuar vitet e kaluara, gjithmonë kanë fituar ata njerëz që kanë qenë pjesë e komisionit, aty gjithmonë ka pas edhe konflikt të interesit. Unë dëshiroj që Komuna sa më shumë të ketë aktivitete kulturore, por edhe në këtë pjesën e përkrahjes duhet pasur shumë kujdes në përkrahjen e grupeve, por edhe për vendimet që janë marrë, duhet bërë ankesa, në mënyrë që të bëhet ndonjë ndryshim.
- Pse Kryetari i Komunës për një kohë të gjatë nuk merr pjesë në asnjë mbledhje të Kuvendit, ku po trajtohen shumë probleme që lidhen me jetën e qytetarit, e ai në asnjë moment nuk e merr luksin për me ardhur këtu?

Yll Rugova, drejtor i Drejtorisë së Kulturës, sa i përket kalendarit të aktiviteteve, bëri të ditur se ende nuk ka një kalendar fiks. Është në proces e sipër që të bëhet një kalendar i centralizuar, ku organizatat që dëshirojnë të kenë njëfarë bashkërendimi të veprimeve, mund ta vendosin aktivitetin e tyre dhe ajo të jetë e centralizuar në një vend. Ne ende e bëjmë me atë metodën e vjetër, ku ata aplikojnë, ne e kemi të listuar në listat tona dhe pastaj japim pëlqimin.

Sa i përket ndryshimeve në subvencione, këtu e kemi tash një lloj sfide. Pajtohem me juve në këtë pikën që komisionet sado që i ftojme nga shoqëria civile, ato gjithmonë mund të jenë të njëanshme dhe gjithmonë mund të ketë konflikt interesi. Janë diku 120-130 organizata të cilat merren p.sh. me kulturë, edhe është shumë vështirë që ato të mbështeten pa e ftuar dikë nga këta 130 persona të jenë pjesë e listës së subvencioneve.

Arben Vitia, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, theksoi se sa i përket dezinfektimit, ai bëhet kur garantohen kushte atmosferike të qëndrueshme. Deri para 10 ditëve këto kushte nuk kanë qenë të qëndrueshme. Javën e kaluar është marrë vendim që gjatë kësaj jave të fillojë procesi i dezinfektimit. Në fillim të javës veç ka filluar trajtimi me larvicid nëpër

ambiente, si në puse, liqene të vogla etj., në kuptimin që me e ndalur zhvillimin e atyre larvave, që kur të fillojë pastaj procesi i dezinfektimit, të mos ketë mundësi të zhvillohen ato si mushkonjat.

Haki Dragusha, për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale:

- Në rrugën "Fehmi Lladrovci", autoambulanca nuk mund të ketë qasje dhe ne derisa të shkojmë te rrethrotullimi i Spitalit, humbim shumë kohë dhe nuk mundemi me mbërri me kohë për thirrjet që i marrim për ofrimin e shërbimeve shëndetësore.

Arben Vitia, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, tha se në vitin e kaluar, në bazë të kërkesës që na është bërë nga Qendra e Mjekësisë Urgjente, ne kemi proceduar në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, ku kjo drejtori është në fazën e hartimit të një plani se si ta bëjmë qasjen nga njëra anë në anën tjetër, që t'i eliminojmë këto shkuarje në dy rrethet për arsye se nga 13 minuta diku, ka rënë tash në 6 minuta koha e reagimit, mirëpo synim i Komunës dhe Drejtorisë së Shëndetësisë është që ta ulim në 5 minuta. Kemi llogaritur që janë diku 30-40 sekonda që humbin nëpër këto rrethe.

Pika e tretë

Diskutim për gjendjen në ndërmarrjet publike komunale.

Kryesuesi hapi diskutimin.

Egzon Azemi tha se ndërmarrjet publike në Prishtinë ishin shembull i një qeverisjeje të mirë në mandatin e kaluar, por tash ekzekutivi është duke shkelur çdo rregullore e çdo ligj, pa ndjekur as procedurat elementare, duke tentuar t'i kapin ndërmarrjet për epshet e partisë së re PSD. Në veçanti, në Ndërmarrja Publike Banesore janë bërë shkelje ligjore dhe ne në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, përkatësisht në Njësinë për politika dhe monitorimin e ndërmarrjeve publike, kemi dorëzuar ankesë në lidhje me shkeljet ligjore që u bënë me dy vendimet që janë marrë nga dy aksionarët, pra nga Dren Kukaj dhe Qëndrim Sahiti.

Unë si aksionar nuk jam njoftuar fare për mbledhje, as nuk kam marrë rend dite, apo ndonjë sqarim tjetër shtesë. Komisioni komunal i aksionarëve, në përbërje nga Dren Kukaj dhe Qëndrim Sahiti, jashtë kompetencave të tyre, në mbledhjet e jashtëzakonshme, të mbajtura më 19.03. 2018 dhe 26.03.2018, kanë marrë vendim që të bëjnë shpalljen e konkursit për zgjedhjen e katër anëtarëve të bordit, më pastaj ngutshëm vendosën që të themelojnë një bord të përkohshëm, në mënyrë që t'i shtyjnë përpara planet e tyre.

Si Kuvend, e kemi obligim të reagojmë dhe t'i tregojmë z. Ahmeti se nuk mund të luaj me ndërmarrjet e kryeqytetit, dhe propozoj që ta shkarkojmë anëtarin e zgjedhur nga Kuvendi i Komunës, aksionarin Qëndrim Sahiti.

Nol Nushi tha se si pikë e rendit u propozua që të diskutohen në përgjithësi për ndërmarrjet publike, jo të diskutohet vetëm për një ndërmarrje, dhe përderisa në këtë qeverisje janë edhe tre drejtorë që vijnë nga LVV-ja, kisha pyetur personalisht secilin se a mendojnë që kjo qeverisje

është duke i kapur ndërmarrjet publike, nëse po, atëherë pse po rrinë drejtorë?! Si mund të bëhesh pjesë e një qeverisjeje që donë me i kapur ndërmarrjet publike?!
Shefki Gashi tha se ndërmarrjet publike komunale të cilat i menaxhon Komuna, po bëhen po thuajse 6-7 muaj ditë që nuk ka kurrfarë raporti, kurrfarë shkrese prej asnjë ndërmarrjeje. Është e vërtetë që në mandatin e kaluar kanë menaxhuar më mirë shumica e ndërmarrjeve, me përjashtim të kësaj për të cilën po diskutohet. Në ato ndërmarrje gjithçka ka ndodhur, dhe tash natyrisht se aty vlon situata edhe ajo situatë duhet me u menaxhuar disi.

Blerand Stavileci, në emër të GP të PDK-së, tha se ndërmarrjet publike nuk duhet më të identifikohen me një person. Nëse është problemi te një person, edhe te këto të cilat vetë i kanë vendosur edhe si emërtime në politikë, tash kapja, çkapja, munden me e bërë vetë, por neve këtu mos me na munduar e maltretuar. Ne këtu duhet pasur diskutim thelbësor mbi performancën e ndërmarrjeve publike. Qytetarëve nuk u intereson as emri i subjektit politik, as personi që i udhëheq, u intereson shërbimi, cilësia, shpejtësia etj. etj., kështu që besoj që duhet më shumë me u orientuar te pjesa konstruktive e problemeve që janë aty.

Fadil Gashi, në emër të GP të AAK-së, tha se unë veç kërkova që kjo të mos futet në rend dite, pasi që këtu dihet se janë interesa të partisë dhe mundohen që të përfitojnë sa më shumë.

Vesel Makolli, në emër të GP të AKR-AA- së, tha se nuk është mirë që të fusim tema në diskutim pa kurrfarë materiali. Për këtë temë nuk kam kurrfarë informate, andaj është një gjë e pakuptimtë dhe po tregohemi joserioz. Jam për me u trajtuar kjo temë, por paraprakisht duhet të diskutohet në KPF, pastaj të silllet në Kuvend. Po shihet se për këtë çështje ka tendenca të caktuara dhe kisha propozuar që këtë temë me e ndërprerë menjëherë.

Dren Kukaj, në cilësinë e aksionarit në Ndërmarrjen Publike Banesore, theksoi se për hir të informimit të opinionit publik, ne si aksionarë të NPB-së prej momentit kur jemi emëruar e zgjedhur si të tillë, na është pamundësuar qasja në atë ndërmarrje. Ajo ndërmarrje nuk ka bord të drejtorëve, nuk ka kryeshef ekzekutiv, mirëpo aty qëndron një njeri, që mbase e kuptoj se paga është 1.700 euro, por e kam të pakuptueshme, e kam të vështirë ta kuptoj se si një organizatë si LVV-ja bie në këtë gjendje e të mbrojë këtë lloj veprimi.

Dua që të shpreh keqardhje, për shkak se jam aksionar në NPB, që të gjitha këto lajme të këqija që janë prodhuar tash e sa kohë në media, tashmë i kanë shkaktuar dëm të pariparueshëm reputacionit të asaj ndërmarrjeje. Unë jam aksionar i emëruar nga Kryetari, Shpend Ahmeti, dhe do të qëndrojë aty.

Agim Gashi tha se ndërmarrjet publike komunale edhe në mandatin e kaluar i kanë përcjellë këto probleme që sot u ngritën, se shumë prej tyre i kanë pasur këta mekanizma të bllokuar për shkak të vetë ekzekutivit të Prishtinës dhe mos caktimit të aksionarëve nga Kryetari i Komunës, dhe në mënyrë analogjike këtu po lidhen problemet. A është e nevojshme të diskutohet? Patjetër që është. Mund të themi se as në raportet e Kryetarit kurrë nuk ka figuruar një fjali raportuese për gjendjen në NPK, dhe nëse dikush është dashur me dhënë përgjegjësi për atë punë, është dashur vetë Kryetari i Komunës. Për t'i trajtuar ashtu si duhet këto çështje, propozojmë që në seancën e ardhshme të jetë si pikë e rendit të ditës.

Eman Rrahmani tha se kesi lloj problemesh kemi pothuajse në secilën ndërmarrje publike komunale, për të cilat duhet me u diskutuar dhe punuar që ato sa më shpejt të zgjidhen. Unë kisha kërkuar nga të gjithë aksionarët që të marrin raportet në të gjitha ndërmarrjet publike

dhe në seancën e ardhshme të vijnë me raporte financiare, me raporte të punës, dhe të shohim se çka është punuar, sidomos në periudhën e vitit 2018, dhe të marrim vlerësimet dhe vendimet e duhura.

Leutrim Retkoceri theksoi se nga diskutimet që u bënë, shihet se ka qenë më se e nevojshme që kjo pikë të jetë në rend dite, dhe disponimi i dy qasjeve e dëshmon dhe e argumenton këtë. Ndërmarrjet publike janë gjysmë funksionale, ose nuk janë funksionale. Ne si Kuvend jemi të obliguar me u dhënë këtyre çështjeve zgjidhje. Unë kisha propozuar që ndoshta prej asaj ndërmarrje publike me filluar me i zgjidhur problematikat edhe të aksionarëve tjerë, se rrethanat kanë ndryshuar dhe me këtë për me i dhënë zgjidhje mos me pasur shumë diskutime, le të qitet që Kuvendi me propozimin për t'i ndërruar dy aksionarët.

Genc Bashota, në cilësinë e aksionarit në ndërmarrjen publike komunale "Trafikun Urban", i emëruar nga Kryetari i Komunës, tha se si aksionar ne nuk përzihemi në mikromenaxhim, do të thotë edhe në konkurse edhe në të tjerat. Pra, ne presim prej bordit me na dhënë një pasqyrë në baza mujore. Me konsideruar që është bërë shkelje për konkursin me rastin e pranimit të punëtorëve në këtë ndërmarrje, është disi pak e tepërt kjo farë pune ende pa u mbyllë procesi. Vetëm desha me tërhequr vërejtjen, ka kohë dalin çështjet, të gjitha auditohen, shikohen dhe mandej mund të merret një vlerësim.

Vala Peshku tha se që në fillim të mbledhjes ishte propozimi që nga mbledhjet e ardhshme të kemi raporte, mbi të cilat ne do të mund të diskutonim për ndërmarrjet publike komunale, e jo me thash e thëna, prej një këndi në këndin tjetër, se kjo as nuk ka rrjedhë logjike, as nuk i sjellë qytetarit kurrfarë benefiti. Jemi duke e krijuar njëfarë konfuziteti pa nevojë.

Qëndrim Sahiti, në emër të GP të PSD-së, tha se nëse prej atij interpretimi ka dalë ndonjë efekt juridik, unë kisha dhënë dorëheqje vetë, pa më shkarkuar kurrkush, por aty nuk ka kurrfarë efekti juridik, për këtë arsye nuk e di pse po e bën kaq të madhe Egzoni, kur ai vetë nuk ka marrë pjesë në pesë mbledhje.

Jeta Rafuna-Hasani kërkoi nga kryesuesi që kjo pikë të qitet në votim.

Adrian Berisha, po ashtu kërkoi nga kryesuesi që kjo pikë qitet në votim.

Leonora Shabani-Bajraktari tha se si GP jemi që kjo pikë të qitet në votim.

Kryesuesi theksoi se nëse e votojmë këtë pikë për shkarkimin e aksionarit, konsideroj se është shmangie nga rregullorja, sepse pika e rendit të ditës është "Diskutim për gjendjen në ndërmarrjet publike komunale", andaj na duhet një interpretim nga zyrtari ligjor.

Fatos Dibra, përfaqësues nga Zyra ligjore, tha se kjo pikë në fillim është votuar si "Diskutim për ndërmarrjet publike komunale", dhe në bazë të Udhëzimit administrativ, rendi i ditës ndryshohet vetëm në fillim. Nëse pika do të ishte: "Propozim për shkarkimin, ndryshimin e një aksionari", kishte me qenë në rregull, por në këtë moment Zyra ligjore konstaton që rendi i ditës nuk mund të ndryshohet, andaj nuk mund të votohet për shkarkim të aksionarit.

Përfaqësuesit e grupeve parlamentare të subjekteve politike të PSD-së, të AAK-së, të AKR-AA-së të LB-së, përfaqësuesi i subjektit politik Nisma dhe përfaqësuesja e pavarur e Kuvendit, në shenjë pakënaqësie rreth propozimit për votim për shkarkimin e aksionarit në NPB, e lëshuan mbledhjen.

Kryesuesi konstatoi prezencën e kuorunit, duke cekur se mbledhja mund të vazhdojë.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin për shkarkimin e aksionarit në Ndërmarrjen Publike Banesore.

Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për, 1 kundër, u miratua Vendimi për shkarkimin e Qëndrim Sahitit, aksionar në Komisionin komunal në Ndërmarrjen Publike Banesore.

Pika e katërt

Propozimrregullorja për të hyrat vetjake të institucioneve kulturore vartëse të Komunës së Prishtinës.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimrregulloren.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua Rregullorja për të hyrat vetjake të institucioneve kulturore vartëse të Komunës së Prishtinës.

Pika e pestë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Policisë së Kosovës – Ministria e Punëve të Brendshme.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimvendimin.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Policisë së Kosovës – Ministria e Punëve të Brendshme.

Pika e gjashtë

Propozimrregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimrregulloren.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e lapidarit kushtuar të rënëve francezë të KFOR-it.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimvendimin.

Kryesuesi konstatoi se më 24 vota për, 2 abstenime, u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e lapidarit kushtuar të rënëve francezë të KFOR-it.

Kryesuesi propozoi që mbledhja të ndërpritet dhe të vazhdojë më 05.06.2018, duke filluar nga ora 10:00.

Vazhdimi i mbledhjes së Kuvendit, më 05.06.2018.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Nol Nushi (PSD), Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Adrian Berisha (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Egzon Azemi (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Valbona Petrovci, e pavarur, Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Sami Salihu (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Milazim Vitija (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Naime Osmani (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Migjen Shala (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Florida Canolli (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Yll Bogaj (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sokol Berisha (AAK), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR-AA), Sami Boroci, (AKR-AA), Arbenita Murseli (AKR-AA), Adelina Fazliji (AKR-AA), Rifat Deri (AKR-AA), Bukurie Canolli (LB) dhe Baton Dushi (Nisma).

Munguan: Uran Ismaili (PDK), Drilon Pireva (PSD), Visare Gashi (PSD) dhe Suzan Kika (AAK).

Pika e tetë

Propozimvendimi për formimin e komisionit vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim.

Kryesuesi tha se ky komision duhet të jetë në përbërje prej 7 anëtarëve, 3 nga ekzekutivi, 3 përfaqësues të Kuvendit dhe 1 anëtar përfaqësues nga Shoqërisë civile.

Halim Halimi, në emër të GP të LDK, për anëtar të komisionit e propozoi Shefki Gashin.
Vala Peshku, në emër të GP të PSD-së për anëtar të komisionit e propozoi Bashkim Behën.
Eman Rrahmani, në emër të GP të LVV-së, për anëtar të komisionit e propozoi Besnik Mujecin.
Ne si GP propozojmë që të votohen anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe anëtarë nga Shoqëria civile, dhe komisioni do ta ketë shumicën, pastaj kur t'i sjellë ekzekutivi emrat e vetë, një nga një ia votojmë edhe ata.

Leutrim Retkoceri, në emër të GP të PDK-së, për anëtar të komisionit e propozoi Migjen Shalën.
Agim Gashi tha se, për hir të një funksionalitetit të bashkëpunimit dhe një transparence që është obligim ligjor, ka qenë dashur me i ditur se kush janë tre anëtarët e propozuar nga ekzekutivi, për arsye se është e obliguar qeveria, përkatësisht kryetari me qenë transparent në këtë punë.

Vala Peshku tha se në Komitetin për Politikë dhe Financa u pajtuam që në komisionin vlerësues të jenë nga një përfaqësues prej LDK-së, PSD-së dhe LVV-së, ndërsa në komisionin tjetër, që është komisioni konsultativ, ju takon grupeve tjera nga një përfaqësues.

Egzon Azemi kërkoi një shpjegim nga Zyra ligjore, se në kompetencë të kujt është zgjedhja e përfaqësuesit nga Shoqëria civile.

Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore, tha se me ligj nuk parashihet se kush duhet ta zgjedh përfaqësuesin e Shoqërisë civile, vetëm ceket se këtë komision e përbëjnë tre anëtarë të propozuar nga Kryetari i Komunës, tre anëtarë nga Kuvendi dhe një nga Shoqëria civile.

Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, tha se në komisione parashihen shumë anëtarë të shoqërisë civile dhe për këtë ne çdoherë i dërgojmë një letër një rrjeti të organizatave të shoqërisë civile që merren me monitorimin dhe punën e kuvendeve komunale dhe komunave. Ata i kanë sjellë dy emra, Albulena Nrecaj, nga organizata Iniciativa për Progres, dhe Allen Meta, nga DIFORDI, që në shqip është Instituti për Zhvillim Demokratik.

Adrian Berisha, propozoi që votimi për përfaqësuesit e këtij komisioni të bëhet në bllok.

Vlora Dumoshi tha se ky komision ka një rëndësi të veçantë, sepse bëhet fjalë për pronën e paluajtshme, andaj ne duhet ditur se cilët emra po na i dërgon ekzekutivi.

Nol Nushi theksoi se ne nuk mundemi t'ia votojmë përfaqësuesit ekzekutivit, pra është e njëjtë sikurse me aksionarët, aksionarët i cakton kryetari, nuk mundemi ne me ia votuar këtu. Për këtë është pushteti i ndarë i asamblesë me ekzekutivin dhe për atë qeverisja lokale dallon prej qeverisjes qendrore.

Fiknete Bejta tha se procesi i konsolidimit të kësaj trupe të Kuvendit nuk mund të plotësohet nëse kemi gjysmë transparencë, nëse nuk i dimë tre emrat e ekzekutivit. Ne e kemi të qartë që nuk mundemi me i votuar të propozuarit e kryetarit, por ne për me e rrumbullakuar duhet me i ditur edhe emrat e propozuar nga kryetari.

Kryesuesi, duke pasur parasysh vërejtje dhe sugjerimeve që u dhanë nga parafolësit, kërkoi nga Zyra ligjore një interpretim ligjor.

Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore, tha se për t'u miratuar ky propozimvendim, propozimi me emra duhet me ardhur prej kryetarit dhe ky propozimvendim nuk mundet me u votuar në mungesë të emrave të ekzekutivit, se ligji thotë: "Kryetari propozon, Kuvendi propozon dhe propozimi miratohet në Kuvend", kështu që përderisa nuk i kemi emrat e përfaqësuesëve, d.m.th. të ekzekutivit, ky vendim nuk mund të kalojë.

Kryesuesi tha se, duke pasur për bazë interpretimin e Zyrës ligjore, konstatoj se nuk ekzistojnë kushtet ligjore për të proceduar më tutje me këtë pikë.

Pika e nëntë

Propozimvendimi për themelimin e Komitetit konsultativ.

Kryesuesi hapi diskutimin.

Eman Rrahmani, në emër të GP të LVV-së, tha se ne propozojmë që të votohen anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe anëtari i Shoqërisë civile, komisioni e ka shumicën, pastaj kur t'i sjellë ekzekutivi emrat e vetë, një nga një ia votojmë edhe ata emra.

Rifat Deri tha se neve këtu na mungojnë emrat e përfaqësuesve të ekzekutivit, kështu që nuk mundemi me i votuar emrat të cilët i propozon Kuvendi pa qenë edhe emrat e ekzekutivit. Ai propozoi që këto dy pika të shtyhen për mbledhjen e radhës.

Leutrim Retkoceri propozoi që kryetarit t'i bëhet kërkesë dhe t'i sjellë emrat e propozuar.

Agim Gashi tha se ne mund të votojmë emrat që i kemi këtu, por fillimisht duhet të zgjidhet dilema e treshit të parë, sepse janë katër të propozuar për treshin, pastaj të shkojmë me versionin, e në seancën tjetër të votohen përfaqësuesit e ekzekutivit, ose mund ta shtyjmë që bashkërisht t'i votojmë në seancën tjetër.

Egzon Azemi kërkoi nga kryesuesi që t'i bëhet presion kryetarit, që për tema të tilla të jenë më të përgatitur. Ne në seancën e kaluar akuzoheshim se po e pengojmë punën, nuk po punojmë në interes të qytetarëve, pra sot po shihet kush po e pengon punën dhe kush po punon në interes të qytetarëve.

Sami Boroci propozoi që këto dy pika të shtyhen për seancën e radhës.

Kryesuesi bëri të ditur se për përfaqësues nga Shoqëria civile në këtë komision është propozuar Allen Meta, ndërsa përfaqësues i ekzekutivit është propozuar Osman Bllaca.

Halim Halimi, në emër të GP të LDK-së, për anëtar të komisionit e propozoi Vlora Dumoshin.

Eman Rrahmani, në emër të GP të LVV-së, për anëtar të komisionit e propozoi Mirsad Vitinë dhe propozoi që në votim të shkohet anëtar për anëtar.

Migjen Shala, në emër të GP të PDK-së, për anëtar të komisionit propozoi Leutrim Retkocerin.

Sami Boroci tha se nuk mund të marrim pjesë në votim për diçka që jemi pajtuar paraprakisht në mbledhjen e KPF-së, dhe sot ka tendencë me devijuar ky proces, duke ndërruar emra, dhe ne detyrohemi me e lëshuar seancën.

Përfaqësuesit e grupeve parlamentare të subjekteve politike të PSD-së, të AAK-së, të AKR-AA-së, të LB-së, përfaqësuesi i subjektit politik Nisma dhe përfaqësuesja e pavarur e Kuvendit, në shenjë pakënaqësie rreth propozimit për votim për anëtarët e Komisionit konsultativ, e lëshuan mbledhjen.

Kryesuesi konstatoi prezencën e kuorumit, duke thënë se në sallë janë 24 anëtarë të Kuvendit dhe mbledhja nuk mund të vazhdojë.

Mbledhja u ndërpre në orën 11:20.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Agim Kuleta



Faqe 20 nga 20